



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
TIRANA PARKING
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë , më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

[Data]: 09/10/2024

Drejtuar: **“LIGUS” Shpk** me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tiranë.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e Hapur, elektronike -Mallra – mbi kufirin e lartëmonetar”**.

Autoriteti Kontraktor ka përzgjedhur këtë procedurë prokurimi, mbi kufirin e lartë monetar, referuar fondit limit të parashikuar, natyrës dhe qëllimit të mallit objekt kontrate, të cilën nuk mund ta ndajë në lote, sepse kontrata nuk përbëhet nga shumë mallra, por kërkohet prokurim vetëm për një artikull/mall objekt prokurimi.

Numri i procedurës: **REF – 16417 – 08-16- 2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Smart Parking”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. datë 54, 26 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“ARTEO 2018” Shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

L82523203F
Numri i NIPT-t

Vlera: **25,200,000** (njëzet e pesë milion e dyqind mijë) **lekë pa TVSH**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

2. **“LIGUS” Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

L51523001S

Numri i NIPT-t

Vlera: **23,736,000** (njëzet e tre milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) **lekë pa TVSH**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

3. **“SAHORA” Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

L91703022T

Numri i NIPT-t

Vlera: **24,500,000** (njëzet e katër milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“ARTEO 2018” Shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

L82523203F

Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme;

Nuk plotëson kriteret e përgjithshme

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Nuk plotëson kriteret e veçanta:

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës

Nuk plotëson kapacitetin ekonomik:

Nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros të lëshuar nga administrata tatimore;

Nuk ka paraqitur bilancet për periudhën e kërkuar në DST;

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.1;

Nuk ka paraqitur deshmi për furnizime të meparshme

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.2;

Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributorë

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.3;

Nuk ka paraqitur katalog/broshurë ose fragment katalogu për pajisjet objekt prokurimi

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.5;

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.6;

Nuk ka paraqitur deklaratën nëpërmjet të cilës duhet të merrte përispër instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve

Nuk ka paraqitur deklaratën nëpërmjet të cilës duhet të merrte përispër instalimin dhe vënien në punë të pajisjeve

2. **“SAHORA” Shpk**

L91703022T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

arsyet e mëposhtme;

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikë 2.3.1;

Në përmbushje të pikës 2.3.1 të kriterëve të kualifikimit operatori "Sahora" Sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1-Faturë nr. 5/2023, lëshuar në datën 08.09.2023, për Shoqërine Rajonale Ujësjetles-Kanalizime Durrës Sh.a, në vlerën 5 306 740,00 lekë pa TSVH, shoqeruar me situacionin përkatës

2-Faturë nr. 3/2023, lëshuar në datën 22.08.2023, për Shoqërine Rajonale Ujësjetles-Kanalizime Durrës Sh.a, në vlerën 4 854 100,00 lek pa TSVH, shoqeruar me situacionin perkates

3-Faturë nr.11/2023, lëshuar në datën 30.10.2023, për Shoqërinë Rajonale Ujësjetles-Kanalizime Durrës Sh.a, në vlerën 2 373 840,00 lek pa TSVH, shoqeruar me situacionin përkatës

4- Faturë nr.12/2023, lëshuar në datën 16.11.2023, për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durres Sh.a, në vleren 4 295 630,00 lek pa TSVH, shoqeruar me situacionin perkates

5- Faturë nr.7/2024, leshuar në datën 25.01.2024, për Shoqërine Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durrës Sh.a, në vlerën 6 541 200,00 lek pa TSVH, shoqeruar me situacionin përkatës.

6-Faturë nr. 8/2024, lëshuar në datën 22.02.2024, për Shoqerine Rajonale Ujesjetles-Kanalizime Durres Sh.a, ne vleren 1 503 640,00 lek pa TSVH, shoqeruar me situacionin perkates.

7-Vërtetim realizim me nr. 1785/1 prot., date 08.08.2024 leshuar nga Agjencia e Pareve dhe Rekreacionit, shoqeruar me kontraten me nr. 1748/10 prot.,date 24.11.2023 me objekt "Kamion me vinç mbi 4.5 ton" e lidhur ne vleren 6,780,000 lek pa Tvsh dhe faturen tatimore nr. 15/2023, date 19.12.2023 per Agjencine e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi i zërave të situacioneve që shoqërojnë faturat tatimore (5/2023, 3/2023, 11/2023, 12/2023, 7/2024 dhe 7/2024) të lëshuar për Shoqerine Rajonale Ujësjetles-Kanalizime Durrës Sh.a, rezulton se mallrat pjesë e këtyre faturave janë pjesë këmbimi për automjete dhe shërbimi i vendosjes së tyre (F.V). Këto lloj mallarsh nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit për shkak paltforma ngritëse e automjeteve (smart parking) është një pajisje teknologjike e projektuar për parkimin e automjeteve nëpërmjet ngritjes së tyre në lartësi. Ndërkohë që pjesët e këmbimit të automjeteve janë elemente specifik përberës të mjeteve rrugore që mundesojnë funksionimin në parametart e duhur të këtyre mjeteve.

Sa i takon kontratës së realizuar me autoritetin kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, rezulton objekti i kësaj kontrate është një mjet rrugor që shërben për transportin e mallrave, përkatësisht Kamion me vinc me peshe mbajtëse mbi 3.5 ton. Nisur nga mënyra e funksionimit si dhe nga qëllimi i përdorimit, arrihet në konkluzionin se malli objekt i kontratës së lidhur me

Agjencine e Parqeve dhe Rekreacionit nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit, për shkak se kjo e fundit nuk është mjet transporti rrugor por është pajisje ngritese mjete për qëllime parkimi. Gjithashtu nga këndvështrimi i funksionimit platforma ngritese nuk është e ngjashme me mjetin rrugor të llojit "Kamion me vinç" pasi (a) platforma ngritese është pajisje statike ndërkohë që kamioni është mjete i lëvizshëm, (b) platforma ngritese shfrytëzon si burim energjie elektricitetin, ndërkohë që kamioni ka si burim energjie karburatin e llojit naftë, pajisja ngritese nuk disponon sisteme drejtimi, sisteme frenimi ndërkohë që kamioni është i pajisur me këto sisteme.

Nisur nga sa më sipër, KVO arrin në konkluzionin se operatori ekonomik "Sahora" Sh.p.k nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të kualifikimit, kontrata e reblizuar nga ky operator nuk kanë objekte të ngjashme me objektin e prokurimit.

Nuk plotëson kapacitetin teknik pike 2.3.2;

Operatori ekonomik "Sahora" Sh.p.k nuk ka paraqitur autorizim prodhuese ose autorizim nga distributori i autorizuar, shoqëruar me dokumentacionin që provon lidhjen e kësaj te fundit me prodhuesin e pajisjeve.

Nisur nga sa më sipër, KVO arrin në konkluzionin se operatori ekonomik "Sahora" Sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.2 të kriterëve të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të specifikuar nga autoriteti kontraktor.

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikën 2.3.3;

Operatori ekonomik "Sahora" Sh.p.k ka paraqitur pajisjen e tipit BP2700T, prodhuar nga Interequipe (Australi). Referuar informacionit që përmban katalogu i pajisjes BP2700T, rezulton se se disa nga specifikimet teknike të pajisjes pjesë e ofertës së operatorit "Sahora" Sh.p.k nuk përputhen me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

-Konkretisht, pajisja BP2700T lejon parkimin e automjeteve me gjatësi 4.173 m (kati 1) dhe 4.465 m (kati 0). Për rrjedhojë gjatësië e automjeteve që lejon kjo pajisje të parkohen është më e vogël se gjatësi e kërkuar nga autoriteti kontraktor, e cila është saktësisht 4.8 m.

- Në lidhje me shpejtësinë/koha e ngritjes së platformës, katalogu i pajisjes BP2700T specifikon se shpejtësia e ngritjes së kësaj pajisje është 2 min/metër. Lartësia e ngritjes së pajisjes është 2.1 m dhe si rrjedhojë koha e ngritjes së platformës së pajisjes BP2700T, e konvertuar në sekonda është 63 sekonda, e cila tejkalon kohën maksimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor e cila është jo më shumë se 45 sekonda.

- Sa i takon gjërësi të postit të parkimit, në bazë të informacionit që përmban katalogu i pajisjes BP2700T rezulton se gjërësia totale e saj është 2.56 m, vlerë kjo që tejkalon gjërësin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor e cila është 2.5 m.

Katalogu i pajisjes BP2700T nuk përmban të dhëna në lidhje me: (a) presionin e pompës hidraulike, (b) presionin e punës së sistemit hidraulik, (c) kohën e nevojshme të ngritjes së platformës (bosh), (d) kohën e uljes së platformës (boshe dhe me automjet), (dh) llojin e bojës dhe kushtet temperaturës së funksionimit.

Nisur nga sa më sipër, KVO gjykon se specifikimet teknike të pasjisjes BP2700T, nuk përputhen me specifikimet teknike të përcaktuar dhe të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nuk plotëson kapacitetin teknik pikën 2.3.5;

Refëruar të dhënave të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatori disponon vetëm 2 punonjës, të cilët në baze të informacionit të dhënë nga operatori, punonjësit kanë profilin e administratorit. Si rrjedhojë arrihet në konkluzionin se operatori Sahora Sh.p.k nuk disponon stafin e kërkuar në kuptim të profileve arsimore si dhe numërit total të punonjesve.

Nisur nga sa më sipër, KVO arrin në konkluzionin se operatori ekonomik "Sahora" Sh.p.k nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të kualifikimit, duke qenë se disponon vetëm 2 punonjës të cilët nuk kanë kualifikimet e duhuara, të kërkuara nga autoriteti kontraktor

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“LIGUS” Shpk**, me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Rruga Aleks Buda, Pallati I Jon 2002, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **23,736,000** (njëzet e tre milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) **lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.